



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Në pajtim me nenin 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës të Kosovës, Ligjin nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Rregulloren nr.01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, Rregulloren e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit nr.02/2016 dhe Rregulloren nr.02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionin të Avokatit të Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

**K O N K U R S**  
për plotësimin e vendit të lirë të punës

**I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar Ligjor, një (1) pozitë**

Numri i referencës: 8/2017  
Grada/Koeficienti: Niveli Profesional – G7/ 9.68  
Mbikëqyrësi: Sekretari i Përgjithshëm  
Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1(një) vjeçare.  
Vendi: Prishtinë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:**

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të Zyrës dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
2. Asiston në hartimin e akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e Shërbimit Administrativ të IAP-it në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
3. Bën rishikimin ligjor dhe gjuhësor të akteve ligjore të Shërbimit Administrativ të IAP-it, siguron që përmbajtja ligjore dhe teknike të jetë e saktë dhe identike në të tri gjuhët zyrtare, si dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.
4. Bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera, dhe dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për Sekretarin e Përgjithshëm;
5. Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim nga Sekretari i Përgjithshëm
6. Merr pjesë në seminare, trajnime dhe konferenca, në suaza të trajtimit të çështjeve nga fushëveprimtaria që ndërlidhen me legjislacionin, të drejtat e njeriut dhe përgjegjësitë tjera nga vendi i punës.
7. Siguron përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesit të Institucionit të Avokatit të Popullit në procedura civile, penale, përmbartuese dhe administrative, në institucionet publike dhe gjykatat e vendit në të gjitha nivelet.
8. Përpilon raporte të rregullta pune nga fusha e përgjegjësisë dhe detyrave të caktuara si dhe kontribuon në përgatitjen e Planit Vjetor të punës së Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm.
9. Bashkëpunon dhe komunikon me institucionet tjera brenda dhe jashtë për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
10. Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

**7. Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në shkencat juridike.
- Së paku 2 (dy) vjet përvojë pune profesionale.
- Njohje të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe, ndërsa preferohet njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
- Vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale, jo më i vjetër se 6 muaj.

---

### **Procedura e konkurimit**

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org).

Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me Konkurs personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Migjeni“, nr. 21, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën [zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org](mailto:zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org), si dhe me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

### **Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga pjestarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 2 mars 2017, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët që kanë aplikuar, por nuk janë përzgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit. Dokumentet që nuk tërhiqen administrohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782.